



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2019:208787

Datë: 13.03.2024

Numri i dokumentit: 05445759

C.nr.315/2016

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtarin Fuad Haliti, në çështjen juridike të paditësit B.V nga Mitrovica, sipas autorizimit e përfaqëson av.Leutrim Ademi, kundër të paditurës K.S.”SIGURIA të cilën sipas autorizimit i përfaqëson Kompania e Avokatëve “Arbresh” me adresë rr.”Qamil Hoxha”, nr.51, Prishtinë, lidhur me kompensimin e dëmit, jashtë seance me datë 13.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

KONSIDEROHET se është tërhequr padia e paditësit B.V, kundër të paditurës K.S.”SIGURIA”, me objekt kontesti kompensim i dëmi.

Arsyetim

Paditësi me datën 03.06.2016 ka paraqitur padi pranë kësaj gjykatë kundër të paditurës K.S.”SIGURIA”, me objekt kontesti kompensim i dëmi.

Në seancën e datës 13.03.2024 paditësi nuk ka prezantuar në seancë edhe pse i njëjti ftesën e ka pranuar në mënyrë të rregullt, mirëpo mungesën nuk e ka arsyetuar, ndërsa e paditura nuk ka kërkuar që seanca të mbahet në mungesë të paditësit.

Në bazë të nenit 409 paragrafi 1 i LPK-së parashihet që 1 “*Në qoftë se në seancën përgatitore nuk vjen pala paditëse, edhe pse është thirrur rregullisht, padia konsiderohet e tërhequr, përveç kur i padituri kërkon që seanca të mbahet.*”

Andaj gjykata duke u bazuar nenit 409 paragrafi 1 i LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË

Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil

C.nr.315/2016, datë: 13.03.2024

Gjyqtari

Fuad Haliti

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi, është e lejuar ankesa brenda afatit prej 15 ditësh, pas marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.